REPUBLIKA E KOSOVËS
KOMUNA GLLOGOC
MUNICIPAL GLLOGOC
06 Nr. 400-16308
Më On. 19.04.2021

KOLEGJI UNIVERSUM

GLLOGOC

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT PËR BASHKËPUNIM TË NDËRSJELLTË

në mes të

Kolegjit UNIVERSUM

dhe

Drejtoria shëndetësisë dhe mirëqenies sociale – Komuna Gllogoc

I. Qëllimi i Memorandumit

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit palët nënshkruese kanë shprehur vullnetin dhe gatishmërinë për bashkëpunim, duke synuar ngritjen dhe zhvillimin e mëtejshëm të njohurive profesionale dhe akademike, dhe ndërlidhjen e mësimit akademik me punë praktike dhe anasjelltas.

II. Fushëveprimtaria

1. Përmes këtij memorandumi të mirëkuptimit, Drejtoria shëndetësisë dhe mirëqenies sociale – Komuna Gllogoc do t'u mundësoj studentëve të Programit të Infermierisë së Kolegjit Universum përfundimin e punës praktike, me kohëzgjatje të dakorduar në mes të palëve.
2. Me anë të këtij memorandumi të mirëkuptimit, Kolegji Universum do t'u mundësoj studentëve ndjekjen me rregull të orarit të praktikës, të përcaktuar nga Drejtoria shëndetësisë dhe mirëqenies sociale – Komuna Gllogoc.
3. Rekomandimi i kandidatëve për punë praktike do të bëhet nga Kolegji Universum, përmes një komunikimi të rregullt dhe transaparent me menaxhmentin e Drejtoria shëndetësisë dhe mirëqenies sociale – Komuna Gllogoc.
4. Kolegji Universum do të siguroj që kandidatët e përzgjedhur të jenë të nivelit të kënaqshëm dhe të kenë potencial për avancim në karrierën e tyre akademike dhe profesionale.

III. Përdorimi i informatave dhe dokumentacioni

1. Palët pajtohen që çdo informacion, dokument apo të dhëna, të shkëmbyera apo të pranuara sipas këtij Memorandumi të Mirëkuptimit, do të përdoren vetëm për qëllime të lejuara dhe brenda përkufizimeve të përcaktuar me këtë dokument. Palët nuk do të shpërndajnë apo bëjnë

Scanned with CamScanner

publike asnjë informacion, dokument apo të dhëna ndonjërës palë për qëllime tjera, jashtë përkufizimeve të përcaktuara me këtë Memorandum apo që mund të bien ndesh me frymën e këtij, pa aprovim paraprak të palës tjetër;

2. Palët do të përdorin dhe trajtojnë çdo informacion, dokument apo të dhëna si komunikim të ndërsjelltë me besueshmëri të plotë;

3. Çdo mosmarrëveshje, keqkuptim në realizimin e këtij Memorandumi, do të zgjidhet në frymën e tolerancës, mirëkuptimit dhe në bazë të suazave të kodit moral.

4. Kohëzgjatja e këtij memorandumi është tre vjet.

5. Ky Memorandum hynë në fuqi ditën e nënshkrimit, përpos nëse parashihet ndryshe me marrëveshje nga ana e palëve të përfshira në memorandum.

Prishtine, më: 19.04.2021

PALËT NËNSHKRUESE

Kolegji UNIVERSUM

KOLEGJI UNIVERSUM O.P. UNIVERSUM PRISHTINË

Alejtin Berisha, Drejtor Ekzekutiv

Drejtoria shëndetësisë dhe mirëqenies sociale
Komuna Gllogoc

REPUBLIKA E KOSOVES · REPUBLIKA KOSOVA · KOMUNA GLLOGOC · REPUBLIC OF KOSOVO · MUNICIPALITY GLLOGOC

Arsim Haziri, Drejtor

Scanned with CamScanner